

Himë Haradinaj u bë anëtar i UÇK-së si 16-vjeçar. U caktua në njësitin e UÇK-së, i cili vepronte në rajonin e fshatit Glllogjan/Glodane.

Gjatë betejës me policinë serbe, e cila u zhvillua më **24.03.1998**, në fshatin **Glllogjan/Glodane**, Gazmendi dhe Agroni u vranë pranë shkollës fillore *Hasan Prishtina*, përderisa Himë Haradinaj ia arriti të tërhiqej. Që të tretë kishin ardhur me qëllim evakuimin e fëmijëve nga shkolla. Por, po atë ditë, Himë Haradinajn e kanë vrrarë të **Liqeni i Radoniqit/Radonjičko jezero**, në vendin e quajtur *Suka e Biteshit*. Kanë shtënë mbi të nga një avion. Trupin e tij të pajetë e kanë gjetur banorët e fshatit Shaptej/Šaptelj, të cilët për këtë menjëherë e kanë informuar UÇK-në. Më pas, trupin e tij e çuan në Glllogjan/Glodane. Trupat e Gazmendit dhe Agronit, policia i ka çuar në morgun e Djakovës/Đakovica, nga ku i ka tërhequr babai i Gazmendit. Që të tre janë varrosur gjatë natës në Glllogjan/Glodane. Sot, ata prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Glllogjan/Glodane.

Burimet: *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oružanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDP-20114; deklarata H.M, FDH-12653; deklarata Xh.Z, FDH-12692; KMDLNI, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 1,2, FDH-23807; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; SHFDUÇK, *Feniksët...* 6, 161-165.

Miodrag (Milorad) Otović

(7.05.1962, serb nga Glllogjani/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Miodragu ka qenë udhëheqës i ndërresës në Shërbimin e Punëve të Brendshme në Deçan/Deçane. Jetonte me familjen në Glllogjan/Glodane. Në datën **24.03.1998**, ai, së bashku me tre kolegë të punës, ishin nisur për të vizituar familjen serbe Stojanović në Dubravë/Dubrava, gjë që ishte detyra e tyre e rregullt. Përderisa po kalonin nëpër **Glllogjan/Glodane**, i takuan në rrugë dy shqiptarë dhe u urdhëruan që të ndaleshin. Por, shqiptarët nuk e respektuan urdhrin dhe ikën me vrap nga vendi i ngjarjes në drejtime të ndryshme. Dy

policë u flugën pas njërit, ndërsa Miodragu me policinë e katërt shqiptarët tjetër. Ky i fundit e hodhi një bombë dore mbi Miodragun dhe kolegun e tij. Drejt tyre kanë shtënë edhe nga një shtëpi të afërt. Miodragu ka mbetur i vdekur në vend.

Burimet: deklarata N.N, FDH-12686; deklarata Lj.S, FDH-12638; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 50; Gjykata e Qarkut Leskovac, K.V. 74/99 (R. Selmanaj), aktgjykimi, 11.01.2000, FDH-1381; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oružanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; SMIP, *Teroristički...*, III, 932; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 106,110; *Pretnjama do slobode*, Oteta istina, num. 14, prill-qershor 2008, 28,29, FDH-20109.

Milovan (Vidak) Vlahović

(5.08.1935, serb nga Ratishi i Epërm/Gornji Ratiš, komuna e Deçanit/Deçani, pensionist, gjashtë fëmijë)

Milka (Radun Marković)

Vlahović

(5.05.1933, serbe nga Ratishi i Epërm/Gornji Ratiš, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, gjashtë fëmijë)

Milica (Vukoje) Radunović

(7.07.1938, serbe nga Dashinoci/Dašinovac, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, tre fëmijë)

Milovani dhe Milka Vlahović kanë jetuar në **Ratishin e Epërm/Gornji Ratiš**, me vajzën Naden dhe djemtë Novakun dhe Milojiçen. Në datën **21.04.1998**, në mëngjes, në fshat kanë hyrë shqiptarët e armatosur, disa prej tyre të veshur në uniforma. Shtënin rrugës. Nga ora 15:00, Nada, Novaku dhe Milojica e kanë braktisur fshatin, ndërkaq në shtëpi kanë mbetur Milovani, Milka dhe Milica Radunović, e cila po atë ditë, por më vonë, u largua në drejtim të Dashinocit/Dašinovac. Ishte kjo hera e fundit kur Milovani, Milka dhe Milica ishin parë të gjallë.

Nga mesi i muajit shtator të vitit 1998, në Gjakovë/Đakovica, në hotelin *Pashtrik*, u ekspozuan rrobat që janë gjetur në trupat e të vrrarëve, që janë nxjerrë nga *Liqeni i Radoniqit/Radonjičko jezero*. Fëmijët e Milovaniit i kanë identifikuar rrobat e të atit. Më 18.09.1998, familjes i është dorëzuar kufoma për të cilën u tha se i takonte